

VENDIM
Nr. 248, datë 18.3.2015

**PËR NGRITJEN E KOMITETIT SHTETËROR, PËR BASHKËRENDIMIN E
PUNËS, PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE NË KUADËR TË NISMËS “LUTJA
E PAQES 2015”, NË BASHKËPUNIM ME KOMUNITETIN SANT’EGIDIO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant'Egidio-s, për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr.9628, datë 30.10.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant'Egidio-s për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komitetit Shtetëror, për bashkërendimin e punës, për organizimin e aktiviteteve, në kuadër të nismës “Lutja e Paqes 2015”, që do të organizohen në datat 6-8 shtator 2015.

2. Komiteti Shtetëror të kryesohet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

a) Nga institucionet shtetërore:

- përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit;
- ministri i Punëve të Brendshme;
- ministri i Mbrojtjes;
- ministri i Financave;
- ministri i Kulturës;
- ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- ministri i Arsimit dhe Sportit;
- ministri i Zhvillimit Urban;
- drejtori i Protokollit të Shtetit;
- komandanti i Gardës së Republikës së Shqipërisë.

b) Me pëlqimin paraprak të tyre, nga një përfaqësues të:

- kabinetit të Presidentit;
- Kryetarit të Kuvendit;
- Bashkisë Tiranë;
- Komitetit të Kulteve;
- Komunitetit të Sant'Egidio-s;
- Komunitetit Katolik, në Shqipëri;
- Komunitetit Ortodoks, në Shqipëri.

3. Komiteti Shtetëror, në kuadër të aktive-teve që do të organizohen për nismën “Lutja e Paqes 2015”, në datat 6-8 shtator 2015, të angazhohet dhe të marrë përsipër këto përgjegjësi:

a) Bashkërendimin e punës për organizimin e aktiviteteve, në kuadër të nismës “Lutja e Paqes 2015”;

b) Përcaktimin e detyrave për institucionet e tyre dhe të varësisë;

c) Bashkërendimin e punës për aktivizimin e fondeve, koordinimin e aspekteve financiare dhe përgatitjen e aktit përkatës për përballimin e shpenzimeve për realizimin e veprimtarive, të parashikuara në kalendarin e aktiviteteve për këtë nismë.

4. Komiteti Shtetëror mblidhet me kërkesën e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në cilësinë e kryetarit të këtij Komiteti.

5. Në mbledhjen e parë të Komitetit Shtetëror zgjidhet sekretariati teknik i këtij Komiteti, i cili ka këto detyra:

- a) Organizon takimet e Komitetit Shtetëror;
- b) Raporton, periodikisht, pranë këtij Komiteti, për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparëshme të tij;
- c) Bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna prej Komitetit;
- ç) Mban procesverbalet dhe harton vendimet e marra nga Komiteti;
- d) Kryen detyra të tjera, që përcaktohen nga kryetari i Komitetit.

6. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Komitetit Shtetëror.

7. Kryetari i Komitetit i raporton, periodikisht, Këshillit të Ministrave për ecurinë e punës së këtij Komiteti.

8. Ngarkohen të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të Komitetit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama